



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 85.
Prishtinë, më 27.01.2014 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jelena Bontić, Petar Miletić, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Vesna Mikić.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja e OSBE-së - Lejla Selimi, përfaqësues nga ECMI - Emin Redepagić dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković**, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 13.12.2013; dhe 17.12.2013;**
- 3. Miratimit i Raportit të Punës për vitin 2013;**
- 4. Hartimi i Planit të punës së Komisionit, për vitin 2014;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesja - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 13.12.2013 dhe 17.12.2013;

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 13.12.2013 dhe 17.12.2013, pa vërejtje.

3. Miratimit i Raportit të Punës për vitin 2013;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Raportin e Punës për vitin 2013, në mënyrë që të përfshihen propozimet dhe sugjerimet eventuale në këtë raport.

Me që nuk kishte propozime shtesë, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri miratoi raportin e punës për vitin 2013.

4. Hartimi i Planit të punës së Komisionit, për vitin 2014;

Kryesuesja- Në bazën të Programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2014, obligohen komisionet të hartojnë Planin e Punës për vitin 2014, deri më 29.01.2014, Propozimet tona duhet të jenë sa më konkrete me qëllim të dhënies së mendimeve dhe sugjerimeve në hartimin e këtij plani. Komisioni duhet ti inkorporojë edhe një numër të çështjeve të paralizuara nga Plani i punës për vitin 2013, siç janë monitorimi i zbatimit të ligjeve që janë në procedurë, etj.

Strategjia legjislative e Qeverisë për vitin 2014, nuk parasheh për shqyrtim asnjë ligj në cilësinë e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Në rast të ndryshimeve dhe plotësimeve të strategjisë, Komisioni ka në kompetencë që periodikisht të kontrollojë planin e vetë të punës me aktivitete dhe të njëjtat t'i harmonizojë me kërkesat dhe nevojat.

Në kuadër, të monitorimit të Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, si kryetare e grupit punues, si propozim dha se nga mesi i muajit shkurt të organizohet Seancë Dëgjimore, më pas GP do të raportojë për shkallën e implementimit të këtyre dy Ligjeve, më pas do të hartojë raportin me rekomandime, për Kuvend.

Elmi Reçica- në fjalinë e tij tha se Grupi Punues, në mënyrë të drejtpërdrejtë është marr me mbikëqyrjen e nivelit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal. Gjithashtu, është bazuar në të dhënat nga dëgjimet e institucioneve relevante si dhe nga vizitat në terren. Tani jemi në fazën përfundimtare ku ka mbetur të pa përfunduara çështja e rekomandimeve.

Ai e udhëzoi stafin mbështetës të komisionit, në fillim të muajit mars të thërret grupin punues në hartimin e rekomandimeve të mbetura. Ai konstatoi se si Komision raportues në muajin janar do të dal me raport rekomandime dhe i njëjti do të dërgohet për miratim në Kuvend.

Kryesuesja – tha se në kuadër të monitorimit të zbatimit të Planit Aksionar të Strategjisë për integrimin e Komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian për vitin 2009-2015, në muajin janar do të radhitet raporti i grupit punues më pas Komisioni do të dal me raport rekomandime, për Kuvend.

Lumnije Morina – theksoi se sipas planit të punës për vitin 2013, kanë mbetur të pa përfunduara monitorimi i disa ligjeve. Sa i përket monitorimit të Strategjisë për integrimin e Komunitetit Romë Ashkali dhe Egjiptian për vitin 2009-2015, grupi punues është në përfundim të punës dhe ishte e mendimit të dilet me raport final në fund të muajit janar 2014, ndërsa aktivitetet tjera të grupeve punuese të radhiten në muaj periodik.

Kryesuesja – bazuar në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ishte e mendimit që Grupi punues aktivitetet e saja ti zhvillojë çdo muaj, periodikisht të realizohen vizitat në teren dhe në muajin maj ose qershor të dal me Raport final.

Jelena Bontic- sa i përket monitorimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, fillimisht është udhëhequr nga kryetari i më hershëm i grupit punues - Goran Marinkovic, andaj nga ajo periudhë GP nuk ka marrë asnjë veprim konkret.

Si kryetare e Grupit punues, akordohet se të thërret takime çdo muaj ku do të identifikohen pyetjet e ndryshme, mbledhja e informatave për zbatimin e planit mbikëqyrës të Ligjit. Ishte e mendimit se në muajin maj të dilet para Komisionit me raport, ndërsa në muajin qershor të hartohet raporti final, për miratim në Kuvend.

Kryesuesja, e njoftoi komisioni se për arsye shëndetësore sot mungon anëtarja e komisionit **Vesna Mikic**, e njëjta ka drejtuar shkresë në emër të komisionit për tu plotësuar Plani i punës edhe me një pikë. Kërkesa e saj është se në kuadër të ndryshimeve kushtetuese të ndryshohen dokumentet e identitetit dhe për këtë lloj ndryshimi komunitetet kanë të drejtë të mbështesin dy shtetësinë -Kosovare dhe serbe.

Ajo ka konsideruar se në bazë të Nenit 78 pika 4, Komisioni, me nismën e vet, mund të propozojë ligje dhe akte tjera në kompetencë të Kuvendit.

Komisioni nuk e miratoi propozimin e Vesna Mikic, me arsye që të njëjtën kërkesë mund ta drejtojë në Ministrinë për Punë të Brendshme dhe Komisionarit për gjuhët .

Kryesuesja – veçoi se organizata e OSBE-së ka paraqit interesim në hartimin e Biltenit-, lidhur me procesin e mbikëqyrjes së Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, dhe mendon se i njëjti do të finalizohet në fund të muajit maj.

Petar Mileti- përkrahu iniciativën e partneritetit të OSBE-së për hartimin e Biltenit, por është skeptik që GP të përfundoj punën e monitorimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, para muajit maj. Ai pajtohet që kjo pikë të figuroj në planin e punës për vitin 2014, por në ndonjë muaj tjetër, pra pas miratimit të planit final për Kuvend .

Myfera Sinik- konsideron se Ligji për Përdorimin e Gjuhëve është një ndër Ligjet më të rëndësishëm për Kosovën prandaj kërkesa e saj ishte që Buletini të botohet edhe në gjuhën turke.

Kryesuesja - theksoi se kemi një propozim të partneritetit të OSBE-së, të përfshihet në plan të punës shqyrtimi i raporteve periodike dhe vjetore të ministrive resurse.

Raportet e kësaj natyre, shqyrtohen nga të gjitha komisionet parlamentare, të njëjtat procedohen për vlerësim në komisionin për buxhet dhe komisionet tjera. Për detaje fjalën ia dha përfaqësueses së OSBES-së.

Lejla Selimi- projekti për shqyrtimin e raporteve periodike, është iniciuar nga GIZ, OSBE-ja dhe NDI-ja andaj mirë është që në muajin prill, komisioni të mbaj një takim për mbikëqyrjen e shpenzimeve tremujore të Ministrive përkatëse.

Secili Komision mund të këtë pasqyrën nëse Qeveria i shpenzon paratë në mënyrë të efektshme. Ajo u shpreh se në takimin e radhës të Komisionit, do të paraqes detajet e këtij projekti të rëndësishëm.

Petar Miletic - konsideron se rishikimi i buxhetit të Ministrive përkatëse është punë dhe përgjegjësi e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisionit për Buxhet. Ishte i mendimit, nëse edhe komisioni ynë do të inkuadrohet në shqyrtimin e raporteve periodike, kjo formë paraqet punë të dyfishtë.

Myfera Sinik – kërkoi sqarim se a është kërkesë e Komisionit apo në mënyrë vullnetare ofrojnë mbështetje organizatat e OSBE-së, zyra e Ambasadës Zvicerane, NDI-së, etj

Kryesuesja – në ushtrimin e aktiviteteve të saja, Komisioni bashkëpunon të ngushtë me ministritë resorë dhe me organizatat ndërkombëtare, siç janë shoqëritë civile, organizatat e OSBE-së, zyra e Ambasadës Zvicerane, ECMI (qendra Evropiane për çështje të Minoriteteve në Kosovë) NDI-ja (Instituti Nacional Demokratik) etj. Komisioni, në raste të veçanta kërkon informata dhe mendime nga këto organizata mirëpo shtoi se ekziston edhe bashkëpunim i ndërsjellët.

Bazuar në propozimet e dhëna, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me datën 27.01.2014, miratoi Planin e Punës për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković